

VENDIM

Nr. 622 , datë 12.11.2001

PER PERCAKTIMIN E ZONAVE KU MUND TE HAPEN KAZINO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000, "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zonat e përcaktuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku mund të hapen kazinotë janë si më poshtë vijojnë:

- a) Zona bregdetare turistike e Vlorës;
- b) Zona bregdetare turistike e Sarandës;
- c) Zona bregdetare turistike e Durrësit;
- ç) Qyteti i Tiranës;
- d) Zona turistike e Velipojës.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

ILIR META